

Termt e Referencës

1. Sfondi i projektit

Në kuadër të projektit “Avokim për krijimin e mekanizmave ligjorë mbështetës në vendin e punës për personat me sëmundje të rënda, projekt pilot i fokusuar tek pacientët e diagnostikuar me kancer”, i financuar nga Community Development Fund (CDF) dhe i zbatuar nga Instituti Columbus, Instituti Columbus shpall thirrje për angazhimin e një eksperti individual për hartimin e një analize ligjore dhe institucionale dhe përgatitjen e një dokumenti politik (policy brief) mbi të drejtat e punëtorëve me sëmundje të rënda (me fokus tek pacientët me kancer) në vendin e punës në Kosovë.

Ky projekt ka për qëllim adresimin e mungesës së mekanizmave ligjorë mbrojtës për punëtorët që diagnostikohen me sëmundje të rënda dhe që përballen me humbje të përkohshme ose të zgjatur të aftësisë për të punuar. Projekti synon të nxisë ndryshime ligjore dhe institucionale që do të sigurojnë të drejtën për trajtim të barabartë dhe të ndjeshëm në vendin e punës për këtë kategori punëtorësh, me fokus fillestar te pacientët me kancer.

Boshllëku ligjor dhe institucional cenon sigurinë në punë dhe mirëqenien e punëtorëve, duke i ekspozuar ata ndaj riskut të humbjes së vendit të punës apo diskriminimit të tërthortë për shkak të gjendjes shëndetësore. Në këtë kontekst, projekti synon të adresojë këto mungesa në mënyrë të strukturuar dhe të qëndrueshme.

Metodologjia e projektit kombinon hulumtimin ligjor dhe analizën krahasimore me qasjen pjesëmarrëse, duke vënë në qendër përvojat dhe nevojat e vetë punëtorëve/pacientëve. Planifikohet rishikimi i legjislacionit aktual dhe praktikave më të mira evropiane, mbledhja e dëshmive dhe tregimeve personale përmes intervistave me pacientë (punëtorë të prekur nga sëmundje serioze), si dhe organizimi i diskutimeve publike me akterë kyç. Një komponent i rëndësishëm i projektit është ndërgjegjësimi publik përmes prodhimit e një dokumentari të shkurtër dhe materialeve të tjera mediatike për të përcjellë gjetjet e hulumtimit dhe tregimet reale të individëve, si dhe për të nxitur debatin shoqëror mbi këtë çështje.

Si rezultat i këtyre ndërhyrjeve, do të hartohet një dokument politik (policy brief) me rekomandime konkrete për ndryshime ligjore e politike që pasqyrojnë standardet më të mira ndërkombëtare dhe parimet e të drejtave të njeriut në vendin e punës. Ky dokument do t’u prezantohet institucioneve përgjegjëse dhe palëve vendimmarrëse, ndërsa përmbajtja e tij do të promovohet edhe tek publiku i gjerë përmes fushatave avokuese. Kjo nismë pilot synon të shërbejë si katalizator për ndryshim sistemik në mbrojtjen e dinjitetit dhe të drejtave të punëtorëve të prekur nga sëmundje të rënda në Kosovë.



2. Qëllimi i Angazhimit

Qëllimi i këtij angazhimi është rekrutimi i një eksperti individual me përvojë, i cili do të kryejë një analizë të thelluar institucionale mbi mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve me sëmundje të rënda në vendin e punës në Kosovë, dhe bazuar në gjetjet e kësaj analize do të hartojë një dokument politik (policy brief) me rekomandime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe politikave përkatëse. Ky angazhim do të sigurojë ekspertizën e nevojshme profesionale për të informuar dhe orientuar veprimet avokuese të projektit, në mënyrë që rekomandimet e ofruara të jenë të argumentuara, të zbatueshme dhe në përputhje me standardet më të mira.

3. Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit

Eksperti i angazhuar do të ketë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- Rishikimi i legjislacionit dhe politikave relevante: Kryerja e një analize të plotë të kuadrit aktual ligjor dhe nënligjor që ndërlidhet me marrëdhëniet e punës dhe përfitimet sociale për punëtorët në rast sëmundjesh të rënda.
- Identifikimi i boshllëqeve në mbrojtjen ligjore: Evidentimi i mungesave dhe dobësive në dispozitat ekzistuese që kanë të bëjnë me mbrojtjen e punëtorëve të prekur nga sëmundje të rënda (veçanërisht rastet e kancerit), duke përfshirë sfidat në zbatimin e tyre në praktikë.
- Analizë krahasimore dhe hulumtim ndërkombëtar: Hulumtimi i praktikave më të mira ndërkombëtare dhe standardeve evropiane sa i përket të drejtave dhe mbrojtjes së punëtorëve gjatë periudhës së trajtimit të sëmundjeve serioze, me qëllim nxjerrjen e mësimave dhe modeleve që mund të përshtaten në kontekstin e Kosovës.
- Bashkëpunim për mbledhjen e informatave empirike: Bashkëpunimi me ekipin e projektit të Institutit Columbus në mbledhjen e të dhënave dhe informatave shtesë, duke përfshirë analizimin e gjetjeve nga intervistat me pacientët (punëtorë të sëmurë) dhe konsultimet me akterë institucionalë ose ekspertë tjerë relevantë.
- Hartimi i raportit analitik të gjetjeve: Përgatitja e një raporti të detajuar të analizës ligjore dhe institucionale, që përshkruan gjetjet kryesore, boshllëqet e identifikuar dhe arsyetimin që qëndron pas nevojës për ndryshime. Raporti duhet të përfshijë gjithashtu rekomandimet fillestare për masat përmirësuese.
- Përgatitja e dokumentit politik (policy brief): Në bazë të raportit analitik dhe konsultimeve me palët e interesit, hartimi i një dokumenti politik të shkurtër që përmbledh gjetjet kryesore dhe ofron rekomandime specifike e të zbatueshme për përmirësimin e kornizës ligjore e institucionale.
- Prezantimi i rezultateve para palëve të interesit: Prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore të analizës në forume dhe ngjarje relevante të projektit, sipas

nevojës. Kjo mund të përfshijë pjesëmarrjen dhe kontributin e ekspertit në tryezën e rrumbullakët me akterët kyç (institucione publike, OJQ, përfaqësues të punëdhënësve, pacientë) si dhe në ndonjë debat publik apo paraqitje mediatike lidhur me projektin, me qëllim shpjegimin e rekomandimeve dhe nxitjen e diskutimit publik.

- Mbështetje në aktivitetet e avokimit dhe komunikimit: Bashkëpunimi me ekipin e projektit në hartimin e mesazheve kyçe për fushatën e sensibilizimit publik dhe materialet mediatike, për të siguruar që komunikimi publik të bazohet në evidenca dhe rekomandimet e identifikuara.

4. Produktet që duhet të dorëzohen

Eksperti pritët të dorëzojë këto produkte kryesore gjatë periudhës së angazhimit:

- Raporti analitik (analiza ligjore dhe institucionale): Një raport i shkruar i detajuar që përmbledh gjetjet e analizës së kuadrit aktual ligjor dhe institucional, identifikon boshllëqet dhe sfidat ekzistuese, dhe ofron bazën faktike e ligjore për rekomandimet e ndryshimeve. Ky raport do të shërbejë si dokument reference për hartimin e politikave dhe për diskutimet me palët e interesit.
- Dokumenti politik (Policy Brief) me rekomandime: Një dokument i shkurtër politikash, i hartuar në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë, që paraqet rekomandimet konkrete për përmirësimin e legjislacionit dhe politikave lidhur me mbrojtjen e punëtorëve të prekur nga sëmundje të rënda. Policy brief-i do të jetë i orientuar drejt vendimmarrësve (p.sh. propozon ndryshime specifike në Ligjin e Punës ose akte nënligjore, masa të reja mbështetëse nga institucionet, etj.) dhe do të përdoret për qëllime avokimi publik.

(Shënim: Dokumentet finale duhet të dorëzohen në format elektronik (Word/PDF) dhe do të jenë në gjuhën shqipe. Përkthimi i tyre në gjuhën angleze mund të kërkohej veçmas, sipas nevojës së donatorit ose palëve të interesuara.)

5. Kriteret e përzgjedhjes

Kandidatët (ekspertët individualë) duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Kualifikimi arsimor: Diplomë universitare (nivel Bachelor) në një fushë relevante, si p.sh. politika sociale, politika shëndetësore, drejtësi, administrim publik apo fusha të ngjashme. Kualifikimi pasuniversitar (Master) në një nga këto fusha është i preferuar.
- Përvoja profesionale: Së paku 5 vjet përvojë pune në hartimin ose analizimin e politikave publike, analizë ligjore, hulumtime sociale, shëndetësore apo fusha të lidhura ngushtë me temën e projektit. Përvoja specifike në çështje që lidhen me të drejtat e punëtorëve, shëndetësi apo mbrojtjen sociale do të vlerësohet lart.
- Eksperiencë në avokim dhe media: Përvojë e dëshmuar në realizimin e fushatave të avokimit apo aktiviteteve të ndërgjegjësimit publik, si dhe aftësi për të komunikuar

efektivisht mesazhe në media. Kjo mund të dëshmohet me pjesëmarrje në nisma avokuese, paraqitje në media (intervista, debate), ose botime (artikuj, hulumtime, analiza opinione) që trajtojnë çështje të politikave sociale/shëndetësore.

- Njohuri të kontekstit lokal dhe ndërkombëtar: Njohuri të shkëlqyera të kornizës ligjore të Republikës së Kosovës, në veçanti Ligjit të Punës dhe legjislacionit lidhur me beneficionet e punëtorëve dhe çështjet e shëndetësisë. Po ashtu, mirëpritet njohja e standardeve ndërkombëtare dhe praktikave evropiane në fushën e të drejtave të punëtorëve dhe mbrojtjes sociale e shëndetësore.
- Aftësi analitike dhe hulumtuese: Aftësi të mira për të kryer hulumtime cilësore e sasiore, për të analizuar legjislacionin dhe politikën, dhe për të sintetizuar informacionin kompleks në përfundime dhe rekomandime të kuptueshme.
- Shkathtësi komunikimi dhe shkrimi: Aftësi shumë të mira komunikuese dhe ndërpersonale. Aftësi të shkëlqyera në të shprehurit në formë të shkruar në gjuhën shqipe, me stil profesional dhe pa gabime. Njohja e gjuhës angleze (sidomos e terminologjisë profesionale) konsiderohet avantazh, duke qenë se rezultatet e projektit mund të komunikohen edhe te audienca ndërkombëtare.

6. Kohëzgjatja e angazhimit dhe orari

Kohëzgjatja e parashikuar e këtij angazhimi është gjashtë (6) muaj, përafërsisht nga tetori 2025 deri në mars 2026. Eksperti i përzgjedhur pritet të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe do të punojë në koordinim të ngushtë me stafin e Institutit Columbus gjatë gjithë periudhës së projektit.

7. Mënyra e aplikimit dhe dokumentet e kërkuara

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të ftuar të paraqesin aplikimin e tyre duke dorëzuar dokumentet e mëposhtme:

- Curriculum Vitae (CV): CV e përditësuar e kandidatit, duke theksuar kualifikimet akademike, përvojën profesionale relevante dhe aftësitë kryesore.
- Letër motivimi: Një letër motivimi (deri në 1 faqe) ku kandidati shpjegon interesimin e tij/saj për këtë pozitë, përmbledh mënyrën se si përvoja dhe aftësitë e tij/saj i përgjigjen kërkesave të angazhimit, si dhe shpalos qasjen personale ndaj temës së projektit.
- Shembuj pune ose referenca: Çdo provë e punëve të ngjashme të realizuara më parë është e mirëseardhur. P.sh. kopje/link i një analize ose policy brief të hartuar nga kandidati.
- Oferta financiare: Një dokument i shkurtër ku tregohet oferta financiare e kandidatit për këtë angazhim. Kjo mund të paraqitet si shumë totale bruto për gjithë periudhën e angazhimit ose si tarifë ditore e propozuar. (Shënim: Instituti Columbus do të sigurohet



që pagesa të jetë konkurruese dhe e drejtë, në përputhje me buxhetin e projektit dhe normat e tregut.)

8. Afati i dorëzimit të aplikacioneve dhe detajet e kontaktit

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është data 15 tetor 2025. Të gjitha dokumentet e kërkuara sipas pikës 7 duhet të dërgohen me email në adresën elektronike: info@instituticolumbus-ks.com më së voni deri më 15 tetor 2025 (ora 17:00).

Luteni që në subjektin e email-it të shënohet “Aplikim për Ekspert - Analizë Ligjore dhe Policy Brief”.

Për çfarëdo informacioni shtesë apo sqarimi, kandidatët mund të kontaktojnë Institutin Columbus në adresën e emailit të lartpërmendur. Pyetjet për sqarim (nëse ka) mund të paraqiten deri më 10.10.2025, dhe përgjigjet do t’u komunikohen aplikantëve me kohë.

Shënim: Aplikimet e pranuar pas afatit të mësipërm, si dhe aplikimet që nuk përmbajnë të gjitha dokumentet e kërkuara, nuk do të merren në shqyrtim.